

V E N D I M

Nr. 789, datë 24.12.1998

PËR PLATFORMËN E FUNKSIONIMIT TË MINISTRISË SË INFORMACIONIT

Në mbështetje të ligjit nr. 8415, datë 8.10.1998 “Për miratimin e strukturës dhe dhënien e votbesimit Këshillit të Ministrave të kryesuar nga zoti Pandeli Majko”, me propozimin e Ministrisë së Informacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Informacionit është pjesë e strukturës së Këshillit të Ministrave, e cila, brenda drejtimeve kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore drejton veprimtarinë e informimit të publikut dhe të medias.

2. Misioni i Ministrisë së Informacionit është:

- Të informojë publikun dhe median për veprimtarinë e qeverisë.
- Të informojë Këshillin e Ministrave për gjykimin që ka opinioni publik dhe media për veprimtarinë e tij.

- Të miratojë, të bashkërendojë dhe të ndjekë zbatimin e programeve dhe te projekteve të ministrive dhe të institucioneve qendrore për komunikimin me publikun dhe median, në përputhje me përparësitë e komunikimit të qeverisë.

- Përparësitë e komunikimit të qeverisë me publikun dhe median përcaktohen brenda muajit të parë të vitit, sipas një dokumenti të nënshkruar nga Kryeministri.

- Të ndërmarë nisma ligjvënëse, që informacioni publik i veprimtarisë së qeverisë të miradministrohet si pasuri kombëtare, si dhe për të plotësuar legjislacionin në fushën e mediave.

3. Zëdhënësit e shtypit të ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, në prefektura, si dhe atashetë e shtypit, të akredituar në përfaqësitë tona diplomatike, jashtë shtetit, emërohen nga titullarët e këtyre institucioneve, me propozimin e Ministrisë së Informacionit.

4. Informacioni i zëdhënësve të shtypit për veprimtarinë e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, të prefekturave, si dhe informacioni i atashëve të shtypit, të akredituar në përfaqësitë tona diplomatike jashtë shtetit, është i përditshëm dhe publikohet në formën e një “Buletini qeveritar”.

Kriteret e këtij informacioni përcaktohen në një udhëzim të posaçëm të ministrit të Informacionit.

5. Projektaktet normative, që paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave dhe në komitetet ndërministrorë, të shoqërohen me një “Komunikatë për shtypin”, e cila duhet të përmbajë informacion me interes për publikun dhe median.

6. Numri i punonjësve të Ministrisë së Informacionit përcaktohet nga Kryeministri. Në strukturën organizative të kësaj Ministrie të përfshihet edhe struktura e Departamentit të Medias, si dhe numri i punonjësve i parashikuar për të në organikën e Kryeministrit.

7. Ngarkohet Ministria e Informacionit të përgatisë projektbuxhetin e vitit 1999 dhe të paraqesë në Këshillin e Ministrave projektvendimin me kërkesat përkatëse për fonde dhe mënyrën e përballimit të tyre. Efektet financiare për përballimin e shpenzimeve për pagat dhe sigurimet shoqërore për vitin 1998 të jenë respektivisht 470 000 lekë dhe 130 000 lekë. Këto efekte përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Për përmbushjen e nevojave emergjente për investime për vitin 1998, Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare i pakësohet fondi për investime prej 6 milionë lekësh, të parashikuara për vitin 1998, të cilat i shtohen Ministrisë së Informacionit në zërin pajisje.

8. Pagat e punonjësve të Ministrisë së Informacionit të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, lidhja II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore”.

Punonjësit e Ministrisë së Informacionit, me përjashtim të sektorit të personelit organizimit dhe shërbimeve, të marrin 45 për qind shtesë mbi pagën mujore, për shkak të veçorive specifike të punës.

9. Ngarkohet ministri i Informacionit të paraqesë për miratim, pranë Kryeministrit strukturën dhe organikën e Ministrisë së Informacionit brenda 5 ditëve nga dalja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko